




REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DEÇANIT

REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF DEÇANI



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA DEÇANI

Zyra Personelit

Nr: 02 /2527

Datë:08/05/2013

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, neni 18 paragrafi 1 dhe 3, neni 20 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 3 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit mbi Shërbim Civil, si dhe Vendimi Nr.02/2527 së Kryetarit të Komunës, Udhëheqësi i Personelit i Shërbimit Civil Komunal shpall këtë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës

1.Pozita : Roje Pylli - një(1) ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë Për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural

Koeficienti – 4.5

Lloj Pozitës - Karrierës

Pozita Funksionale : Nëpunës i nivelit Administrativ

Orari Punës ; 40 ore në Javë

Mbikëqyrja : nga Drejtori

Detyrave të punës:

- Garanton mbrojtjen e integritetit të pyllit dhe të tokave bujqësore nga çdo dëmtim apo përvetësim kundërligjor;
- Mbron pyjet nga prerjet ilegale, nga sëmundjet dhe dëmtuesit bimor;
- Kontrollon kullosat në regjionin e caktuar dhe bën mbledhjen e taksave nga kullotat;
- Mbron dhe evidenton shtazët e egra dhe llojet e imëta, si dhe llojet e larta;
- Legjitimeon dhe kontrollon prezencën e individëve në pyll, si dhe veprimet e tyre;
- Informon dhe merr masa preventive, si dhe asiston në shuarjen e zjarreve;
- Merr pjesë në damkimin e trungjeve në pyjet e larta të pronës shtetërore dhe private;
- Kryen edhe punë të tjera nga natyra e punës, dhe për punën e vet i përgjigjet përgjegjësit të njësisë komunale për pyje;

Kushtet: Përgatitja e mesme shkollore.

Do të ftohen vetëm kandidatë të cilët hynë në listën e ngushtë:

Shërbimi civil i Komunës është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga meshkujt dhe femrat e të gjitha komuniteteve të Kosovës

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor, kandidatet e interesuar mund të marrin dhe të dorëzojnë aplikacionet e plotësuara në zyrën e pranimi – Arkivi i Komunës së Deçanit

VREJTJE:Aplikacionit duhet të bashkëngjitet dëshmia mbi kualifikimin shkollor, dokumenti mbi përvojën e punës, kopja e letërnjoftimi, si dhe referencat dhe certifikimet tjera nëse i posedon kandidati.

Për çdo informacion mund të drejtoheni në Zyrën e personelit Nr. 4.

Udhëheqësi i Personelit

Ismet Kukleci